



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

K.DH.SH.II.nr.963/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhomat e Shkallës së Dytë, me gjyqtarin Krenar Berisha, ne çështjen juridike përmbarimore të kreditorit Komuna e Podujevës Rruga “Zahir Pajaziti” ndaj debitorit Petrol Company shpk, me seli në Prishtinë magjistralja Prishtinë-Fushë Kosovë, me bazë juridike përmbarimore, duke vendosur lidhur me ankesën e kreditorit, e paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale-Dhomat e Shkallës së Parë, KPPP nr.192/2022 datës 12.04.2023, me datën 31.01.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET e pabazuar ankesa e kreditorit Komuna e Podujevës rruga “Zahir Pajaziti”, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale - Dhomat e Shkallës së Parë, KPPP nr.192/2022 i datës 12.04.2023, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale-Dhomat e Shkallës së Parë, me aktvendimin KPPP nr.192/2022 dt.12.04.2023, në pjesën I të dispozitivit të aktvendimit ka Pranuar si të bazuar prapësimin e debitorit Petrol Company shpk, i paraqitur kundër Urdhrit përmbarimor P.nr.1709/2018 datës 04.06.2018, i Përmbaruesit Privat Flamur Bogaj në Prishtinë, ndërsa ne pjesën II të dispozitivit të këtij aktvendimi ka Shfuqizuar Urdhrin Përmbarimor P.nr.1709/21018 dt.04.06.2018 të lejuar nga Përmbaruesi Privat.

Kundër këtij aktvendimi, në afatin ligjor ka paraqitur ankesë kreditori, përmes përfaqësuesit të Komunës për konteste juridike, pa precizuar bazat e veçanta ligjore, me propozim që gjykata e shkallës së dytë ta Aprovoj këtë ankesë dhe lënda të kthehet në rivendosje apo rishqyrtim në shkallë të parë.

Dhomat e Shkallës së Dytë, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbarimore si dhe në kuptim të nenit 194 dhe 208 të LPK-së, gjeti se:

-Ankesa e kreditorit është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori Komuna e Podujevës rr.“Zahir Pajaziti” nr.1, me datën 04.06.2018 ka paraqitur propozim për përmbarrim ndaj debitorit Petrol Company shpk, në bazë të dokumentit të besueshëm-Faturës nr.15-330/04-0033011/18 dt.23.04.2018. Përmbarruesi Privat Flamur Bogaj nga Prishtina, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit, me urdhrin përmbarrimor P.nr.1709/18 dt.04.06.2018, ka lejuar përmbarrimin, me të cilën detyrohet debitori që kreditorit në emër të borxhit që rrjedh nga fatura, ti paguaj shumën prej 2,750.00 euro, me kamatë ligjore si dhe shpenzimet e procedurës.

Kundër aktvendimit për lejimin e përmbarrimit, debitori me datën 22.06.2018, ka paraqitur prapësim, me pretendimin se propozimi për përmbarrim nuk është legjitim sepse debitorit e ka marrë me qera objektin nga viti 2015 kështu që fatura para kësaj date nuk është obligim i debitorit, e si provë sjell kontratën e datës 02.03.2015, Organi përmbarrues nuk do të duhej ta lejonte përmbarrimin duke injoruar në tërësi procedurat ligjore nga neni 29 i LPP-së, sepse në rastin konkret dokumentet e besueshme nuk janë të përshtatshme për përmbarrim sepse nuk e kanë të përmbushur kushtin ligjore dhe atë si me lartë përkatësisht nuk e kanë afatin e pagesës, faturat duhet të jenë të ndara për secilin vit, e jo një faturë e vetme për 7 vite, borxhi nga kjo faturë është parashkruar, ashtu qëe propozon që gjykata ta aprovoj prapësimin e debitorit dhe ta anuloj në tërësi urdhrin përmbarrimor.

Përgjigje ndaj prapësimit të debitorit ka ushtruar kreditori me datën 02.07.2018, me arsyetimin se debitorit i është dërguar fatura dhe njoftimi për pagesën e borxhit, aktvendimet për secilin vit i janë dorëzuar, në secilin aktvendim është shënuar llogaria e kreditorit dhe data e fundit për të cilën është dashur të behet pagesa e borxhit, propozon që gjykata ta refuzoj prapësimin e debitorit dhe urdhri përmbarrimor të miratohet .

Gjykata Komerciale – Dhomat e Shkallës së Parë, pas vlerësimit të prapësimit dhe përgjigjes në prapësim ka nxjerr aktvendimin KPPP.nr.192/22 dt.12.04.2023, me të cilin e ka Pranuar si të bazuar prapësimin e debitorit dhe ka Shfuqizuar urdhrin përmbarrimor, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktvendimit të atakuar. Ka arsyetuar se prapësimi i debitorit është i bazuar sepse në rastin konkret fatura në bazë të cilës është lejuar urdhri përmbarrimor nuk i përmban të gjitha elementet e kërkuara me nenin 29 të LPP-së. Gjykata vlerëson se urdhri përmbarrimor bazohet në dokumentin/faturën nr.15-330/04-0033011/18 datës 23.04.2018, por e njëjta nuk i përmban të gjitha elementet e kërkuara me ligj pasi edhe pse është e paraqitur në kopje të vërtetuar noteriale e njëjta nuk përmban asnjë të dhënë sa i përket arritshmërisë së kërkesës, fatura nuk përmban as vulën e as nënshkrim përkatës nga debitori, andaj edhe ka vendosur si në dispozitiv të vendimit të saj.

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata Komerciale – Dhomat e shkallës së dytë, vlerëson se dhoma e shkallës së parë i ka zbatuar drejtë dispozitat e Ligjit të Procedurës Përmbarrimore kur e

ka aprovuar prapësimin e debitorit, ngase edhe sipas vlerësimit të kësaj gjykate me shikimin në shkresat e lëndës qartë konstatohet se përmbartimi është lejuar në bazë të faturës se lëshuar nga kreditori, në mënyrë të njëanshme, e cila faturë nuk përmban elementet që kërkohen me nenin 29 par.3 të LPP-së.

Dhoma e shkallës së dytë, vlerëson se dhoma e shkallës së parë në bazë të provave të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendim në pajtim me dispozitat ligjore, prandaj përfundimin juridik të dhomës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe kjo gjykatë, me çka mbi bazën e këtyre rrethanave dhe fakteve kësaj gjykate i rezultoi se aktvendimi i ankimuar i nxjerrë nga dhoma e shkallës së parë është i drejtë dhe i bazuar. Edhe kjo gjykatë vlerëson se fatura me numër nr.15-330/04-0033011/18 dt.23.04.2018, nuk është në pajtim me dispozitat ligjore dhe atë nenin 29 të LPP i cili parasheh që *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbartim po që se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbartjes së detyrimit monetar”*, e që në rastin konkret fatura e lartcekur si e tillë nuk plotëson kushtet ligjore për të qenë dokument i besueshëm, sepse e njëjta nuk është e vërtetë nga debitori si dhe as e nënshkruar nga i njëjti, element ky bazë që shpreh vërtetësinë e pranimit të një dokumenti, dhe se e njëjta nuk është pranuar në mënyrë të rregullt ashtu që del të jetë e lëshuar njëanshëm. Po ashtu kjo gjykatë vlerëson se me Udhëzimin Administrativ Nr.15/2010 PËR ZBATIMIN E LIGJIT NR. 03/L-222 MBI ADMINISTRATËN TATIMORE DHE PROCEDURAT, i cili në nenin 20 par.1 nenpar.1.17 parasheh që *“Në minimum, një faturë duhet të jetë e nënshkruar nga shitësi, nëse klienti apo blerësi është në dispozicion për të nënshkruar, ai person duhet po ashtu të nënshkruajë faturën tatimore”*, andaj marrë parasysh faktin se fatura nuk është nënshkruar nga debitori dhe se në shkresat e lëndës nuk ka prova se e njëjta është pranuar në mënyrë të rregullt nga debitori rezulton se kjo faturë nuk mund të jetë e përshtatshme për përmbartim.

Gjykata nuk i aprovoi si të bazuara pretendimet ankimore se debitori ka pranuar faturën, dhe aktvendimet e kreditorit për pagimin e borxhit, sepse fatura përmbartimore bashkangjitur propozimit për përmbartim nuk i plotëson kushtet ligjore për tu konsideruar si dokument i përshtatshëm për përmbartim nga neni 29 të LPP-së. Kjo gjykatë sqaron se ekzekutimi i detyrimeve monetare nga subjektet e ndryshme juridike në procedurën përmbartimore, pavarësisht statusit të tyre dhe objektit të përmbartimit (i.e. qofshin ato licenca apo borxhe afariste), i nënshtrohet shqyrtimit juridik-formal të dokumentit përmbartimor apo atij të besueshëm mbi bazën e të cilit është lejuar përmbartimi. Hyrja në raport juridik me palët debitore dhe inicimi i procedurës përmbartimore nuk nënkupton se mund të anashkalohen prerogativat ligjore të parapara me dispozitat e nenit 29 par.3 të LPP-së, ku në rastin konkret kreditori nuk dëshmon me asnjë provë se dokumenti përmbartimor, është pranuar nga debitori. Andaj bazuar në këto arsye kjo gjykatë vlerëson se pretendimet e kreditorit janë të pabazuara dhe jo relevante për një vendosje ndryshe ashtu që i refuzoi si të tilla ndërsa aktvendimin e atakuar e vërtetoj.

Përndryshe në procedurën përmbarimore bëhet realizimi direkt i mbrojtjes juridike të konstatuar në dokumentin përmbarimor i cili përmban aktin juridik me të cilin vërtetohet ekzistimi i kërkesës dhe se nga ky dokument rrjedh e drejta e organit përmbarues që sipas propozimit të kreditorit të caktoj dhe zbatoj përmbarimin.

Kompetenca e Dhomës së Shkallës së Dytë për të vendosur nga ana e gjyqtarit individual bazohet në dispozitën e nenit 3 paragrafi 2 të LPP-së, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 208 dhe 209 paragrafi 1 pika (b) të LPK lidhur me nenin 17 të LPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS  
Dhomat e Shkalles se Dytë  
K.DH.SH.II nr.963/23 me datë 31.01.2024

Gjyqtari,  
Krenar Berisha